



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujevo

## DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në bazë të nenit 17 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe ansferte, nr. 01/111-400 të datës 28 maj 2012 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, si dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2018 nr. 01-400/-01-0072029/17, datë 19.09. 2017, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, bën:

### FTESË PUBLIKE

Për aplikim në projektin:

#### “RRITJA E SIPËRFAQEVE TË PRODHIMIT ME BIMË MJEKUESE DHE AROMATIKE NË SIPËRFAQE PREJ 2.5 HA NË KOMUNËN E PODUJEVËS”

*(Projekti do të realizohet në bashkëpunim nga Komuna e Podujevës dhe “ Agroprodukt VM” Podujevë, sipas Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur më 05.06.2018)*

**Përfitues: 25 fermerë,**

**Sipërfaqja: 10 ari për fermer**

### KUSHTET PËR APLIKIM

- Të jetë banor i Komunës së Podujevës;
- Të jetë i regjistruar në regjistrin e identifikimit të fermerëve (NIF);
- Dëshmia e sipërfaqes së tokës punuese mbi 30 ari;
- Dëshmia e posedimit të burimeve të ujit për ujtiqe;
- Certifikata e bashkësisë familjare;

### Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Kopja e letërnjoftimit
- Vërtetimi i tatimit në pronë
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme
  
- Afati i aplikimit: nga data 16.07.2018 deri më 31.07.2018
- Aplikacionet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë, objekti i Komunës zyra nr.14

Nr. 12-320/01-0055757/18  
Podujevë, korrik 2018



Drejtori  
Vezir Januzi